



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	21.05.2024
REFERENC-Ë:	23/7378/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Guri Company-1", Sh.p.k, Belincë, Komuna Shtime Thermim dhe seperim i gurit gëlqeror.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka kontrolluar dokumentacionin për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Guri Company-1", Sh.p.k, Belincë, Komuna Shtime, për veprimtarinë: Thërmim dhe seperim i gurit gëlqeror, Belincë, me Nr. Prot. 23/7378/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

- Vendimi për ndërprerje të procedurës administrative për operatorin, "Guri Company-1", Sh.p.k, Belincë, Komuna Shtime, për veprimtarinë: Thërmim dhe seperim i gurit gëlqeror,

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure


Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 23/7378/MMPHI
Datë: 21.05.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe neni 9 paragrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatori, "Guri Company-1", Sh.p.k, Belincë, Komuna Shtime, i ndërpritet **procedura administrative** për veprimtarinë: Thërmim dhe seperim i gurit gëlqeror, në ngastrën, nr. 654-0, zona kadastrale Belincë Komuna Shtime.



Arsyetim

Pas pranimit të kërkesës për Leje Mjedisore nga operatori, "Guri Company-1", Sh.p.k, Belincë, Komuna Shtime, për veprimtarinë: Thërmim dhe seperim i gurit gëlqeror, në ngastrën e nr. 654-0, zona kadastrale Belincë Komuna Shtime, Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për leje Mjedisore ka kontrolluar dokumentacionin dhe në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve si në vijim:

- Lejen për aktivitete të veçanta nga KPMM për seperacion;

Komisioni për Leje Mjedisore ne takimin e mbajtur të datës: 21.05.2024, konstatoi se operatori " Guri Company-1", Sh.p.k, Belincë, Komuna Shtime, për veprimtarinë: Thërmim dhe seperim i gurit gëlqeror, në ngastrën e nr. 654-0, zona kadastrale Belincë Komuna Shtime, nuk i plotëson kriteret e parapara për vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore, pasi qe nuk e ka kompletuar dokumentacionin e cekur me lartë ne afatin kohorë të përcaktuar në nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, **mbyll procedurën administrative**, në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Shtime ;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit

- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.

